FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

MORFINE

Tretësirë për injeksion - 10 mg / ml (1%)
(Morfinë klorhidrat)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Morfine dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Morfine
3. Si ta merrni Morfine
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Morfine
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË MORFINE DHE PËRSE PËRDORET

Morfina është një analgjezik narkotik, që shkakton analgjezi me anën e veprimit më shumë qendror sesa periferik në perceptimin e dhimbjes. Ajo vepron edhe në muskulaturën e lëmuar, duke rritur tonin, sidomos të sfinkterëve të aparatit tretës, duke shkaktuar ulje të peristalzës. Efektet farmakologjike të morfinës janë: analgjezia, përgjumja, përndryshimi i mënyrës së sjelljes (euforia), ulja e temperaturës së trupit dhe në varësi të dozës edhe deprimimi i frymëmarrjes.
Frenimi i kollës shkaktohet nga efekti i drejtpërdrejtë në qendrën medulare.
Morfina përthithet shpejt pas injektimit në muskul ose nën lëkurë. Nivelet plazmatike maksimale shfaqen brenda 30 minutash pas injektimit në muskul. Morfina shpërndahet shpejt në organizëm, por kryesisht në indin parenkimatoz, si p.sh. në veshka, mëlçi dhe shpretkë. Përqëndrime më të ulëta janë gjetur në muskulaturën e skeletit. Sasi të vogla të morfinës e kalojnë barrierën hematoencefalike. Morfina nuk qëndron gjatë në inde dhe 24 orë pas marrjes së dozës së fundit, përqëndrimet janë mjaft të ulëta. Morfina kalon përmes placentës dhe gjurmë të saj janë gjetur në djersë dhe në qumështin e gjirit. Rreth 33% e barit lidhet me proteinat, kryesisht me albuminën. Morfina metabolizohet kryesisht në mëlçi me anën e konjugimit me acidin glukuronik në grupin 3 – hidroksilik dhe në një shkallë më të vogël në grupin 6 – hidroksilik. Gjysmëjeta e jashtëqitjes është afërsisht 1.5 deri në 2 orë në subjektet e shëndetshëm dhe 90% e dozës largohet me anën e urinës brenda 24 orësh. Afërsisht 7 deri në 10% e dozës largohet me anën e feçeve. Ka të dhëna se jashtëqitja urinare e morfinës mund të rritet me anën e uljes së pH - it të urinës.
Morfine përdoret në:
- qetësim të dhimbjeve mesatare deri të forta, në tumoret malinje, pas traumave të rënda, pas operacioneve dhe infarkt miokardi;
- astmë kardiake;
- edemë pulmonare akute;
- obstruksion vaskular periferik;
- shok traumatik;
- emboli pulmonare;
- kolika abdominale, renale e biliare;
- paramjekim para anestezisë së përgjithshme.

Morfina përdoret edhe në urgjencat e tjera, si psh. në insufiçiencën e ventrikulit të majtë, perforim abdominal dhe hematemezë.
Morfina redukton ankthin që shoqëron dhimbjen e rëndë dhe përdoret si hipnotik në rastin kur pagjumësia shkaktohet nga dhimbja.

2. PËRPARA SE TË MERRNI MORFINE

Mos merrni Morfine:
- në qoftë se jeni i ndjeshëm (alergjik) ndaj morfinë klorhidratit, ndaj opiateve, ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të Morfine - tretësirë për injeksion;
- pas ndërhyrjeve kirurgjikale në traktin biliar ose anastomozave kirurgjikale;
- në qoftë se keni rritje të presionit intrakranial ose trauma të kokës (ndikon në frymëmarrje dhe në reagimin pupilar që është jetik në vlerësimin neurologjik);
- në qoftë se keni abdomen akut ose ileus paralitik;
- në qoftë se keni stazë të bronkeve;
- në qoftë se keni insufiçiencë renale, hepatike ose respiratore;
- në qoftë se keni insufiçiencë kardiake të lidhur me sëmundje respiratore kronike;
- në qoftë se vuani me alkoolizëm akut, delirium tremens;
- në qoftë se vuani nga gjendje konvulsive, si p.sh. status epilepticus, tetanus (për shkak të efekteve nxitëse në palcën e kurrizit) ose në helmimet me strikninë;
- në qoftë se përdorni ose keni përdorur deri 2 javë më parë frenues të monoaminoksidazës (IMAO);
- në qoftë se keni feokromocitomë.

Morfine nuk duhet të përdoret në fëmijët e lindur para kohe ose gjatë lindjes.

Tregoni kujdes të veçantë me Morfine
Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Morfine.
- Morfina duhet përdorur me kujdes në të sëmurët me: hipotension, hipotiroidizëm, astmë dhe ulje të rezervës respiratore, insufiçiencë adrenokortikale, hipertrofi të prostatës, shok, stenozë uretrale, çregullime inflamatore apo obstruktive të zorrës, pankreatit, aritmi kardiake, kor pulmonar të rëndë, miasteni gravis.
- Kujdes duhet patur gjatë shtatzënisë dhe ushqimit me gji. Fëmijëve të lindur nga nëna që kanë përdorur vazhdimisht morfinë mund t'ju shfaqet sindromi i abstinencës. Morfina shfaqet në qumështin e gjirit, kështu që përdorimi i saj nuk rekomandohet gjatë periudhës së ushqyerjes së fëmijëve me gji.
- Në të sëmurët me dëmtim të funksionit të mëlçisë mund të shkaktojë komë (ndonëse shumë të sëmurë të tillë e tolerojnë mirë morfinën).
- Doza e morfinës duhet ulur në çregullimet e funksionit të veshkave, në të moshuarit dhe në të sëmurët e dobësuar.
- Morfina dhe në përgjithësi analgjezikët narkotikë duhen përdorur vetëm për një afat të shkurtër për qetësimin e dhimbjeve që nuk dominohen nga analgjezikët jonarkotikë.
- Si rezultat i përdorimit të dozave të përsëritura, morfina mund të shkaktojë varësi fizike dhe psikike; ndërprerja e menjëhershme e trajtimit me morfinë në këta të sëmurë mund të shkaktojë sindromën e abstinencës, përfshirë edhe konvulsione.
- Përdorimi në fëmijë rezervohet vetëm për rastet e domosdoshme.

Marrja e barnave të tjera
Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga morfina.
Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me morfinë në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit.
Është veçanërisht e rëndësishme që mjeku juaj të jetë në dijeni të faktit që ju jeni trajtuar ose keni marrë:
- deprimues të sistemit nervor qendror, si: opioidet e tjerë, qetësuesit, gjumësjellësit, anestezikët, antidepresantët triciklikë, barbituratet dhe fenotiazinat, antihistaminikët sedativë, alkool, sepse mund të rrisin efektet deprimuese të morfinës.
- Kombinimi i morfinës me frenuesit e monoaminoksidazës (IMAO) mund të shkaktojë deprimim të theksuar të frymëmarrjes, hipotension dhe hiperpireksi.
- Kur morfina merret në të njëjtën kohë me cimetidinën, i sëmuri duhet mbikqyrur me kujdes për rritjen e efektit deprimues të frymëmarrjes dhe të sistemit nervor qendror; nga ana tjetër ky kombinim mund të shkaktojë apne dhe konfuzion.
- Efektet e morfinës mund të frenohen nga veprimtaria pjesërisht antagoniste e pentazokinës.
- Efektet bllokuese neuromuskulore të tubokurarinës forcohen nga morfina.
- Ritonavir mund të ulë përqëndrimet plazmatike të morfinës.
- Morfina rrit biodisponibilitetin e gabapentinës.
- Morfina mund të ulë efektin e diuretikëve.
- Rifampicina rrit ndjeshëm metabolizmin e morfinës dhe redukton efektet e saj.
- Nuk duhet të përdoret njëkohësisht me nalmefenin.
- Analgjezikët opioidë theksojnë efektet e oksibatit të natriumit, ndaj duhet të shmanget përdorimi i njëkohshëm.
- Veprimi i morfinës në peristalzën gastrointestinale mund të ndikojë në përthithjen e barnave të tjera.

Marrja e Morfine me ushqim dhe pije
Nuk duhet të merret me alkool sepse përforcohen efektet hipotensive, sedative dhe çregullimet e frymëmarrjes.

Shtatzënia
Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut përpara se të merrni këtë bar.
Morfine 1% nuk duhet të merret gjatë shtatzënisë. Fëmijëve të lindur nga nëna që kanë përdorur vazhdimisht morfinë mund t'ju shfaqet sindromi i abstinencës.

Ushqimi me gji
Morfine kalon në qumështin e gjirit, kështu që përdorimi i saj nuk rekomandohet gjatë periudhës së ushqyerjes së fëmijëve me gji. Është e domosdoshme që nëna të konsultohet patjetër me mjekun para se të marrë Morfine.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Nuk duhet të drejtoni automjetin apo të përdorni makineri gjatë trajtimit me morfinë sepse disa nga efektet anësore të saj janë: eufori, marrje mendsh, përgjumje, çregullim orientimi.

Informacion i rëndësishëm për disa nga përbërësit e Morfine
Tretësira për injeksion Morfine përmban metabisulfit natriumi, i cili mund të shkaktojë rrallë reaksione të rënda mbindjeshmërie dhe bronkospazmë.

3. SI TA MERRNI MORFINE

Gjithmonë merreni Morfine sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj. Në qoftë se ndjeni që efektet e Morfine janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.
Dozimi i Morfine është si më poshtë:
- *Në dhimbjet akute, me injektim nën lëkurë ose në muskul:* 10 mg, që në rast nevoje përsëritet çdo 4 orë (15 mg në të sëmurët trupmëdhenj e me peshë të rëndë).
  Fëmijët deri në 1 muaj: 0.15 mg/kg peshë; 1 – 12 muajsh: 0.2 mg/kg peshë; 1 – 5 vjeç: 2.5 – 5 mg; 6 – 12 vjeç: 5 – 10 mg.
  Me injektim të ngadalshëm në venë: ¼ - ½ e dozës përkatëse që injektohet nën lëkurë ose në muskul.
- *Në infarkt miokardi, me injektim të ngadalshëm në venë* (2 mg/min.): 10 mg e që në rast nevoje mund të vazhdohet edhe me 5 – 10 mg të tjerë; për të sëmurët e moshuar ose të dobësuar doza përgjysmohet.
- *Në edemë pulmonare akute, me injektim të ngadalshëm në venë* (2 mg / min.): 5 – 10 mg.
- *Në dhimbjet kronike, me injektim nën lëkurë ose në muskul:* 5 – 20 mg, çdo 4 orë; doza mund të rritet në përputhje me nevojat.

Në qoftë se keni marrë më shumë Morfine
Ky bar do ju administrohet në spital, ndaj nuk ka shumë gjasa që të ndodhë mbidozim, gjithsesi njoftoni menjëherë mjekun nëse mendoni se keni marrë një dozë më të lartë se ajo që duhet.

Në qoftë se keni harruar të merrni Morfine
Ky bar do ju administrohet në spital, ndaj nuk ka shumë gjasa që të ndodhë harresë, gjithsesi nuk duhet marrë dozë e dyfishtë (ose më e lartë), për të kompensuar dozën e harruar.

Në qoftë se ndërprisni trajtimin me Morfine
Trajtimi nuk duhet të ndërpritet menjëherë. Ndërprerja e menjëhershme shkakton sindromën e abstinencës.
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, morfina mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.
Pjesa më e madhe e efekteve anësore janë të lidhura me dozën dhe zhduken kur doza reduktohet ose kur trajtimi ndërpritet. Disa efekte anësore mund të ndodhin në fillim të trajtimit dhe zhduken në mënyrë spontane me vazhdimin e mjekimit.
Morfina mund të shkaktojë:
- çregullime gastrointestinale (të përziera, të vjella, konstipacion, dhimbje abdominale, anoreksi, dispepsi, spazma biliare, tharje goje, përkeqësim të pankreatitit);
- çregullime kardiovaskulare (hipotension, hipotension ortostatik, bradikardi, takikardi, palpitacione);
- çregullime në sistemin nervor qendror (marrje mendsh, përgjumje, eufori, disfori, haluçinacione, delir, çregullime të orientimit, rritje të presionit intrakranial);
- çregullime në lëkurë (djersitje, kruarje, urtikarie);
- çregullime të frymëmarrjes (deprimim të frymëmarrjes, apne, ndalim të frymëmarrjes, laringospazma, deprimim të refleksit të të kolliturit);
- çregullime urogjenitale (spazma të ureterëve, mbajtje të urinës, efekt antidiuretik, reduktim të libidos dhe / ose të potencës seksuale);
- çregullime muskuloskeletore (ngurtësim, parestezi, rabdomiolizë);
- çregullime të shikimit (shikim i turbullt, miozë, nistagmus).

Janë konstatuar edhe çregullime të shijes, ndryshime të mënyrës së sjelljes, varësi fizike e psikike, dhimbje në vendin e injektimit, irritim lokal dhe forcim i vendit të injektimit.
Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI MORFINE

Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni Morfine pas datës së skadimit e cila është e shënuar në paketim!
Mos e ruani mbi 25°C!
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Morfine
Lënda vepruese është morfinë klorhidrat.
Çdo ampulë 1 ml përmban 10 mg morfinë klorhidrat.
Përbërësit e tjerë janë: klorur natriumi, metabisulfit natriumi, acid klorhidrik, ujë për injeksion.

Përmbajtja e paketimit
Kuti me 10 ampula.

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:

Sipas recetës së mjekut.
Përmbajtja. Kujdes.
Tretësirë për injeksion.

Mbajtësi i autorizimit për tregtim dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Korrik 2016.

SPECIFICATION

CROPING AREA 15 X 25 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible. If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.